



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranimi Pratfjere	19.01.2026	
Njesia Jednoca	Komuna Opština	Shtojca Dodatak
01-052/01-2756		

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës në dhjetor të vitit 2025

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton raport nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-dhjetor 2025 i cili është mbajtur me datën 19.12.2025, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) për Administratë të Hapur në komuna.

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/660977.pdf>

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1.Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	66
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	66

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë 66 pjesëmarrës, prej tyre 30 femra dhe 36 meshkuj.

Takimi i cili është mbajtur **19.12.2025** duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal kishte karakterin informues për të gjithë pjesëmarrësit. Përfaqësuesit e komunës kanë njoftuar për aktivitetet komunale, të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të japin propozime lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të tyre dhe gjithë qytetarëve të tjerë.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoi kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti ku takimin e filloi duke i njoftuar të pranishmit për punën gjatë periudhes janar-dhjetor 2025 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.







Kryetari Ahmeti shprehu kënaqësinë për investimet e realizuara gjatë vitit, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai cilësoi vitin 2025 si një vit shumë të suksesshëm, duke ia atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit.

Në këtë takim, Kryetari Ahmeti u shpreh i kënaqur për trendin e investimeve të realizuara gjatë vitit 2025, e të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai e cilësoi vitin 2025 si një vit shumë të suksesshëm, duke ia atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit për bashkëpunimin e ndërsjellët.

Gjatë takimit me qytetarë, Kryetari Ahmeti vlerësoi të kënaqshëm realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2025, i cili ka qenë i suksesshëm dhe se deri në fund të vitit pritet të arrijë deri në 95% të realizimit; investimet kapitale kanë arritur rreth 76% të realizimit. Ndërsa, të hyrat vetanake kanë shënuar progres të jashtëzakonshëm, duke tejkaluar planifikimin buxhetor.

Deri më tani kemi realizuar mbi 60 projekte, por po i veçoj disa nga më të rëndësishmet, si: ndërtimi i QKMF-së në Lipjan, e cila sigurisht që do t'i përmirësojë kushtet dhe shërbimet për qytetarët tanë, ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës, ndërtimi i vazhdimit të sheshit dhe parkut të qytetit, renovime të shkollave, asfaltime të rrugëve e shumë projekte të tjera.

Kryetari Ahmeti theksoi se në sektorin e bujqësisë fermerët janë përkrahur përmes subvencioneve për pajisje të ndryshme të mekanizimit bujqësor, si dhe përmes formave të tjera të subvencioneve; po ashtu janë mbështetur edhe klubet sportive dhe OJQ-të e ndryshme lokale.

Ndër të tjera, Kryetari Ahmeti ka theksuar se Komuna e Lipjanit është renditur ndër komunat me performancë të mirë, sipas vlerësimeve nga organizata dhe institucione vendore e ndërkombëtare. Për transparencë buxhetore, Komuna e Lipjanit është renditur e para nga organizata GAP dhe ka marrë vlerësime të larta nga KDI dhe organizata të tjera.

Kryetari Ahmeti u shpreh i bindur se në vitin e ardhshëm do të realizohen edhe më shumë projekte, ndonëse përmendi edhe sfidat që kanë shoqëruar punën e deritanishme. Ndër sfidat kryesore, ai theksoi mungesën e mbështetjes nga niveli qendror dhe çështjet e lidhura me kontratat kolektive.

Qytetarët e pranishëm në takim shprehën mirënjohje për angazhimin e Kryetarit Ahmeti dhe kabinetit të tij për realizimin e projekteve të shumta që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e komunës.

Ata gjithashtu paraqitën kërkesa për investime të reja kapitale në të ardhmen. Në përmbyllje të takimit, Kryetari Ahmeti falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e qeverisjes së hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente në shërbim të qytetarëve.

Po ashtu qytetarët prezent kanë pasur rastin të bëjnë pyetje rreth shumë çështjeve me rëndësi të marrin përgjigje nga vet kryetari Imri Ahmeti.

Pastaj Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, e hapi diskutimin për të pranishmit.


Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	ka thënë se në Janjevë janë bërë disa investime por ka ende nevojë për asfaltimin e disa rrugicave, ndriçimi publik etj.	Behxhet Konxheli nga Janjeva	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ka potencuar se Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të investojë në secilin fshat duke u nisur nga prioritetet.	Komenti u pranua Plotësisht

Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	tha se në fshatin Akllap ka pasur investime gjë që e falenderoj komunën por ende kemi nevojë andaj kërkoj nga kryetari që të buxhetoj edhe investimet si që është kanalizimi, ndriçimi publik dhe zgjerimi i rrugës që është e ngushtë dhe ndërtimi i disa urave.	Muharrem Gashi nga fshati Akllap	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ka potencuar se Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të investojë në secilin fshat duke u nisur nga prioritetet dhe duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	tha se në fshatin Grackë ka nevojë për ndriçim publik, trotuarë, rregullimi i një hapësirë publike për këndin e lojërave dhe projekte të tjera.	Ali Sopa nga fshati Grackë	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se janë bërë disa investime në Grackë, por do të planifikohen edhe kërkesa tjera që dalin nga banorët duke u nisur nga ato më prioritare.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	ka shprehur falenderime për Kryetarin Imri Ahmeti, lidhur me investimet që janë bërë në fshatin Gadime si psh. renovimi i QMF-së, asfaltimi i rrugicave, ndriçimi publik e shumë projekte të tjera por që ka nevojë edhe për projekte shpesh dhe në të njëjtën kohë kërkoj nga Kryetari Ahmeti që të fusë në buxhet projektet që konsiderohen më prioritare për banorët e Gadimes.	Muhamet Mustafa nga fshati Gadime	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se Komuna e Lipjanit të gjitha projektet e propozuara nga ana e qytetarëve i planifikon në buxhet sipas prioritetëve të tyre, andaj organizohen edhe dëgjimet buxhetore që të merren të gjitha propozimet e fshatrave dhe lagjeve dhe ato me kryeore të futen në buxhet	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në	ka paraqitur një kërkesë për demolimin e disa objekteve banesore shumë të vjetruara e	Liridon Tërshana, nga Magurja	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se i përket banesave në Magurë i kemi rregulluar ato, mirëpo janë edhe disa të tjera që	Komenti u pranua Plotësisht

dhjetor të vitit 2025	që po paraqesin rrezik për qytetarët e Magurës nga rrënimi i tyre.		nuk e kemi lejen e institucioneve përgjegjëse për rrënimin e tyre por në momentin që e marrim lejen ne do vazhdojmë edhe me rrënimin e tyre.	
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	ka kërkuar që të bëhet një investim në parkingun afër burimit të ujit të nxehtë në Baicë.	Sheremet Kolshi nga Baica	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se do të marrë parasysh këtë kërkesë dhe do të buxhetoj në vitet e ardhshme.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	ka kërkuar të bëhen investime në renovimin e shkollës së vjetër në Banullë.	Afrim Hajrullahu nga Banulla	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se po janë buxhetuar edhe shkolla e vjetër në banullë e Dobrajë e Madhe për intervenim në to.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2025	ka falenderuar kryetarin Ahmeti për asfaltimin e një rrugeqë ka përfunduar së fundi dhe ka pyetur se a do të vazhdoj bartja e nxënësve me autobus nga lagjeja e Akllapit për në shkolla.	Zymer Ahmeti, përfaqësues i lagjes së Akllapit	Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se vazhdoj transporti -bartja e nxënësve me autobus nga të gjitha fshatrat dhe nga lagjeja e Akllapit për në shkolla.	Komenti u pranua Plotësisht:

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun


Bukurie Zejnullahu-Jashari

Lipjan, 19.01.2026

**REGJISTRI I PREZENCËS SË QYTETARËVE NË DËGJIMIN
PUBLIK TË MBAJTUR ME 19.12.2025 NË SALLËN E KUVENDIT
ME FILLIM NË ORA 10,00**

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Haki Shalg	Vrellë	
2	AFRIN LASHUJANI	BANULLË	
3	Eniher Trachani		
4	Shyqirxhe Sadiku	Banullë	
5	Ashim Sopjani	Jelate Lipjan	Ashim Sopjan
6	ILAZ BEDEDE	RAJLA	
7	ALI SONI	Gnoçkë e Vogël	
8	ARMAN BYTYCI	LIPJAN	
9	Muharrem Gashi	AKELAP	
10	NIZMI KRASNIA	LUGË	
11	Abedin Jash	TORE	
12	HALIL KRASNIA	LUGË	
13	GENRI SWANI	ORINOÇ	
14	Ymer Hysni	Lipjan	
15	Sarandë Sadiku	Lipjan	
16	Arbora Moreva	Lipjan	
17	Behare Kongjeli	Lipjan	
18	Miranda Bytyci	QYLAÇ	
19	Ena Kadriu	Magurë	
20	Ganimete Bitoi	Ribari Madhir	
21	Arjeta Krenzi	Gadime e Ulët	
22	MALBURE QERIMI	Gadime e Epërme	
23	ASJA VITJA	KONJUH	
24	Artinesa Kappaz	Shalë	
25	Skender Mehmeti	Lipjan	
26	BURIM ARIFI	KD1	
27	ZAIM BASTIU	KD1	
28	Habib Ollari	Jeta e Re	
29	FADIL ALU	GADIME ULËT	
30	Mastar Rexhepi	Kryetar Fshati	
31	Hasan Shkurti Gani	Doban e Ena	
32	NAJIB REÇICA	GILAVICE	
33	HYRA BYTYCI	QYLAÇ	
34	XHYRIE PRUSTEMI	BANULLË	
35	Nosi Dujlovi	VERDITË	
36	Shkurti Gashi	BALÇ	
37	Milutin Shal	KICKO	

38	Leunita Gadui	Dobrajë	IN
39	Valdona Fenizi	Gllagoc	
40	Fatbardhë Shurdhigi	Hollagi vogël	
41	Isheh d' Sipi Thaku	Lipjan	
42	Laurita Ahmeti	Lipjan	
43	Liridë Simini	Lipjan	
44	Mentë Mogardhi	Lipjan	
45	Behrim Vllashtari	Lipjan	
46	Bukurije Zyrra	Lipjan	
47	VALBONA SOPA	SHOVI	VAIBOJA
48	OSMAN KOLKEZI	SHOVI	
49	BARDHYL IBRAHIMI	Gllagoc	
50	Lumë Djeva	Lipjan	
51	Manigona Bujtyqi	Lipjan	
52	Albana Gërlaku	Lipjan	
53	Neulide Halimi	Lipjan	
54	Donita Sahitoll	Topitlan	
55	Lorena Kozhani	Ribar, Madhe	
56	Leonida Aslari	Hallat, Vll	
57	Kamra Podrimiri	Lipjan	
58	VALDEIN PASHTI	TOFINE	
59	Emal Gudu	DOBRAJE e M.	
60	Bleron Llugioji	Dobrajë e M.	
61	Leart Haliti	Dobrajë e Madhe	
62	Joje Osmani	Rabush i Muhareme	
63	Mehdi Avdyk	Breg i Zi	
64	Behar Khami	Shqipëri	
65	Alispet Xh.	Ribari i rejt	
66	ISAK SHALA	VRELLE Galeshi	